



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS, (KGJK) në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4 paragrafi 1 pika 1.15 të Ligjit nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 30 paragrafi 1 të Rregullores mbi Organizmin dhe Veprimtarin e Brendshme të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në mbledhjen e 178- të të mbajtur me 27 prill 2017, nxjerr këtë:

VENDIM

1. Miratohet Rregullorja Nr.02/2017 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores Nr.11//2016 për vlerësimin e performancës së gjyqtarëve.
2. Vendimi hyn në fuqi me datë 27 prill 2017.



Nehat Idrizi,

Kryesues

Këshilli Gjyqësor i Kosovës


Kopje e vendimit i dërgohet:

- Të gjitha Gjykatave
- Anëtarëve të Komisionit për Vlerësimin e Performancës së Gjyqtarëve
- Arkivi



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



Këshilli Gjyqësor i Kosovës, duke u bazuar në nenin 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 19 të Ligjit Nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenin 10 dhe 11 të Ligjit Nr.5/L-033 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit, Nr.03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, në mbledhjen e 178-të, mbajtur me datë 27 prill 2017 miraton këtë:

RREGULLORE (NR. 02/2017)
PËR NDRYSHIMIN DHE PLËTSIMIN E RREGULLORËS(11/2016) PËR VLERËSIMIN E
PERFORMANCËS SË GJYQTARËVE

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i kësaj Rregulloreje është plotësimi dhe ndryshimi i Rregullores (11/2016) për vlerësimin e performancës së gjyqtarëve(tutje Rregullorja).

Neni 2

1. Neni 20 i rregullores bazë, pas paragrafit 1, shtohet paragrafi i ri me tekstin si ne vijim:
2. KGJK-ja do të caktojë tre (3) gjyqtarë – anëtarë rezervë të Komisionit për Vlerësim të Performancës së Gjyqtarëve në rast se anëtarët nuk mund të marrin pjesë për shkaqe objektive ose konflikt interesi.
2. Neni 20 i rregullores bazë, në paragrafin 4 pas togfjalëshit “mandati i anëtarëve” shtohet togfjalëshi “ dhe anëtarëve rezervë”

Neni 3
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi datën e miratimit nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

Prishtinë, më datë 27.04.2017



Nehat Idrizi

Kryesues, Këshilli Gjyqësor i Kosovës